

BARKODI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS
AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE

PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2012

I DETYRUAR

E shtunë, 2 qershor 2012

Ora 10.00

Lënda: Letërsi dhe Gjuhë shqipe

**Shkollat e mesme pedagogjike
(kurrikula e vjetër)**

Udhëzime për nxënësin

Testi në total ka **25 pyetje**, 13 pyetje me zgjedhje (alternativa) dhe 12 pyetje me zhvillim.
Testi është i ndarë në dy pjesë.

Në të tri pjesët ka pyetje me **zgjedhje** dhe me **zhvillim**. Në pyetjet me zgjedhje rrethoni **vetëm** shkronjën përbri përgjigjes së saktë, ndërsa për pyetjet me zhvillim është dhënë hapësira e nevojshme për të shkruar përgjigjen.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është **2 orë e 30 minuta**.

Pikët për secilën kërkesë janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa	1	2	3	4	5	6	7	8	9
Pikët									
Kërkesa	10	11	12	13	15	16	17	18	19
Pikët									
Kërkesa	20	21	22	23	24	25a	25b	25c	25d
Pikët									

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

PJESA I

GJUHË SHQIPE

Malka më shumë bisedonte me kalin, sesa me njerëzit dhe më shumë kujdesej për të, sesa për pesë kalamajtë dhe të shoqen. Kur errej krejt, e fuste në ahur, i hidhte në kurriz një rrobë për t'i pirë djersën dhe, duke ia mbushur grazhdin me bar, i thoshte:

- U lodhe shumë sot, Kiçooo! Po mos kujto se unë nuk u lodha. Sigurisht, o bukurosh, ti je lodhur më shumë. Prandaj ha, të bëftë mirë! Por, po nuk punuam, me se do t'i ushqejmë ata pesë kalamaj dhe atë të shkretë grua? Tani ngopu, o xhan i Malkës, këputi dhe një gjumë në këmbë, si bën raca jote e bekuar, kurse mua këtu më ke.

Po të ishte dimër, ai flinte atje, në grazhd, mbi bar, mbuluar me një jorgan të vjetër e të leckosur. Në verë flinte përjashta. Rrallë i kalonte netët në kasolle, me gruan dhe fëmijët. Më keq se aq, zor se rronte njeriu.

Fragment nga tregimi "Buka" i shkrimtarit Fatmir Gjata

Për pyetjet nga 1 deri në 7 rrethoni alternativën e saktë.

1. Qarkoni ndërtimin që është fjalë e urtë. **1 pikë**
 - A) Këputi një gjumë në këmbë.
 - B) E ka zënë gjumi i ariut.
 - C) Nuk vë gjumë në sy.
 - D) Gjumi është vëllai i vdekjes.
2. Qarkoni ndërtimin ku janë përdorur dy fjalë homonime. **1 pikë**
 - A) prit gomar të mbijë bar – shkel mbi bar.
 - B) bar i njomë – pimë kafe në një bar veror.
 - C) kërkon gjilpërën në bar – nuk ha bar.
 - D) disa kokrra bar për gripin – bli një bar pluhur.
3. Fjala të leckosur është: **1 pikë**
 - A) fjalë e përngjitur.
 - B) fjalë e formuar me paranyjëzim.
 - C) fjalë e formuar me prapashtesë.
 - D) fjalë e formuar me paranyjëzim dhe prapashtesë njëkohësisht.
4. Në cilin ndërtim fjala udhë është përdorur me kuptim të figurshëm? **1 pikë**
 - A) Bredh udhëve gjithë ditën.
 - B) I jep udhë problemit.
 - C) Sa udhë keni bërë?
 - D) Udhë të mbarë!

5. Folja e përdorur në fjalinë *Prandaj të bëftë mirë* është: **1 pikë**
- A) në kohën e tashme të dëshirores.
B) në kohën e tashme të dëftores.
C) në kohën e tashme të lidhores.
D) në kohën e pakryer të lidhores.
6. Fjalja *Mua këtu më ke gjithë natën* është: **1 pikë**
- A) fjali njëkryegjymtyrëshe me vetë të përcaktuar.
B) fjali njëkryegjymtyrëshe me vetë të përgjithësuar.
C) fjali e thjeshtë dykryegjymtyrëshe.
D) fjali njëkryegjymtyrëshe pavetore.
7. Qarkoni fjalën e shkruar gabim: **1 pikë**
- A) ndihet i lodhur
B) ai do të lexoj
C) të bëftë mirë
D) qenke ftohur
8. Përcaktoni klasën e fjalëve të nënvizuara në fjalinë e mëposhtme: **2 pikë**
- Ai më shumë kujdesej për kalin, sesa për të shoqen, që bënte shumë punë.*
- sesa: _____
- shumë: _____
9. Gjeni llojin e përemrave të nënvizuar në fjalinë: **3 pikë**
- Ai kujdesej shumë për të. Atë kalë nuk ia besonte askujt.*
- (për) të: _____
- atë: _____
- askujt: _____
10. Tregoni në ç'kohë është folja në këtë fjali dhe ç'lloj kallëzuesi formon ajo. Shkruani formën e kësaj foljeje në mënyrën dëftore, koha e pakryer, veta e parë njëjës, forma joveprore. **3 pikë**
- Sigurisht, o bukurosh, ti je lodhur më shumë.*
- koha e foljes: _____
- lloji i kallëzuesit: _____
- forma e foljes: unë _____

11. Gjeni funksionin sintaksor të fjalëve të nënvizuara në fjalinë:

2 pikë

Po të ishte dimër, ai flinte atje, në grazhd, mbi bar, mbuluar me një jorgan të vjetër e të leckosur.

me një jorgan: _____

të vjetër: _____

12. Gjeni një rrethanor në fjalinë e mëposhtme, tregoni llojin e tij dhe me se është shprehur:

3 pikë

Malka më shumë bisedonte me kalin, sesa me njerëzit dhe më shumë kujdesej për të, sesa për pesë kalamajtë dhe të shoqen.

rrethanori: _____

lloji: _____

shprehur me: _____

13. Gjeni llojin e fjalive të nënrenditura në fjalinë e mëposhtme.

Nuk i vinte re fëmijët që prisnin, sepse nuk mund t'i shikonte dot ato fytyra.

lloji i fjalive të nënrenditura:

2 pikë

14. Bëni skemën e fjalisë së mësipërme

1 pikë

PJESA II

Balzak – “Evgjeni Grande” (fragment)

Vdekja e Grandesë

Më në fund çastet e agonisë po afroheshin, ai alamet trup i fortë, i ngjeshur, filloi të përleshet me shkatërronjësen e çdo gjëje të gjallë, me vdekjen. Më kot Evgjenia me Nanonë, përpiqeshin ta bindnin që të mbulohej dhe të rrinte shtrirë; atij i pëlqente të qëndronte në vatër pranë zjarrit, pranë derës ku gjendej thesari. I merrte ato mbulesa, i mblidhte kruspull dhe i thoshte Nanosë:

- Kyçe këtë derë se mos më vjedhin!

Dhe kur kishte fuqi të hapte pak sytë, aty ku ishte përqendruar e tërë jeta e tij, i kthente dhe i mbërthente shpejt e shpejt nga dera e hekurt, ku dergjeshin thesaret dhe me zë të dredhur prej një paniku të brendshëm i thosh së bijës:

- Janë aty? Aty janë?

- Po, baba!

- Hapi sytë katër; kujdes për florinjët! M'i sill këtu para syve të mi!

Evgjenia i shtronte ar mbi tryezë dhe ai rrinte orë të tëra duke kullotur sytë mbi verdhushkat, tamam si ajo fëmija që porsa fillon t'i shquajë sendet, nga njëri te tjetri dhe sodit si e habitur të njëjtin send. Nga buzët e plakut shkëputej atëherë një nënqeshje e pikëlluar, e brengosur.

- Sa ma ngroh zemrën ky i shkretë!- thosh nganjëherë dhe fytyra e tij shkëlqente nga drita e lumturisë.

Kur arriti prifti i famullisë për ta kunguar, sytë e bablokut, të cilët prej disa orësh dukeshin si të shuar, me ta parë kryqin, shandanët, vazën e argjendit të kungatës u ringjallën. Nishani që kish në majë të hundës, u lëkund për të fundit herë. Kur prifti ia afroi kryqin e praruar në buzë për ta puthur, ai shtriu, i babëzitur e i llahtarshëm, dorën që ta kapë; ky mundim i fundit i kushtoi jetën.

Thirri Evgjeninë, megjithëse e kish pranë; po sytë i qenë veshur dhe nuk e pa dot të gjunjëzuar që po derdhte lot mbi dorën e tij të ngrirë.

- Më jep uratën, baba!- iu lut e bija.

- Më ruaj me kujdes çdo gjë! Do të më japësh hesap atje lart.- tha plaku duke provuar me këto fjalët e tij të fundit se krishtërimi duhej të qe feja e koprracëve.

Për pyetjet nga 15 deri në 20 rrethoni alternativën e saktë

15. “Evgjeni Grande” është roman: **1 pikë**
- A) romantik;
 - B) realist;
 - C) psikologjik;
 - D) filozofik.
16. Plaku Grande dallohet për këtë tipar karakteristik: **1 pikë**
- A) dhimbsurinë;
 - B) maniakerinë;
 - C) pasivitetin;
 - D) pesimizmin.
17. Ngjarjet në roman zhvillohen në: **1 pikë**
- A) Paris;
 - B) Ruan;
 - C) Somyr;
 - D) Tur.
18. E vetmja gjë që e qetëson plakun Grande është: **1 pikë**
- A) besnikëria e Nanosë.
 - B) prania e së bijës.
 - C) pamja e arit mbi tavolinë.
 - D) ngrohtësia që i jep zjarri.
19. Në këtë fragment plakun Grande e zë shpesh paniku, sepse: **1 pikë**
- A) ka frikë nga vdekja.
 - B) ka frikë mos e vjedhin.
 - C) mund të vdesë i vetmuar.
 - D) po e lë vetëm Evgjeninë.
20. Në takimin me priftin, plakun Grande përpiqet: **1 pikë**
- A) t’i japë atij amanetet e fundit.
 - B) t’i lutet t’i falë mëkatet.
 - C) t’i marrë kryqin e artë.
 - D) të shmangë çdo kontakt me të.

21. Si është dhënë portreti i Grandesë në këtë fragment? Gjeni të paktën dy shprehje, që japin thelbin e këtij portreti. **4 pikë**

22. Si është qëndrimi i plakut Grande ndaj Evgjenisë tani që ndodhet përballë vdekjes së pashmangshme? A ka ndryshuar ai? Pse? **3 pikë**

23. Cili është raporti që vendos plaku Grande midis vdekjes që po e merr dhe pasionit për para? **2 pikë**

24. Kjo skenë kulmore e romanit përshkohet nga një dramacitet i thellë. Shpjegoni se nga buron ai. Argumentoni mendimin tuaj me ilustrime (të paktën dy) nga teksti. **4 pikë**
